Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0553

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vjosa Gradinaj - Kryetare duke vendosur sipas ankesës së OE " AS Tech " SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim dhe mirëmbajtje të klimave në QKMF dhe njësit e saj" me numër të prokurimit 73350-23-6551-2-3-6, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – QENDRA KRYESORE E MJEKSISE FAMILJARE, më 06/11/2023, mori këtë:

Vendim

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik "AsTech" SH.P.K., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 07.08.2023 (me numër protokolli 553/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim dhe mirëmbajtje te klimave ne QKMF dhe njësit e saj" me nr. të prokurimit: "73350-23-6551-2-3-6", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Qendra Kryesore e Mjekesise Familjare, ndërsa vërtetohet vendimi i Autoritetit Kontraktues i dates 17.07.2023.

II. Vërtetohet njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Qendra Kryesore e Mjekesise Familjare të datës 17.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

III. Urdhërohet Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 27.06.2023, Qendra Kryesore e Mjekesise Familjare, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim dhe mirëmbajtje te klimave ne QKMF dhe njësit e saj" me nr. të prokurimit: 73350-23-6551-2-3-6. Ndërkaq me datën 17.07.2023 eshte publikuar njoftimi mbi vendimin e AK me të cilin ka shpërblyer me kontratë "TERMOVISION" SH.P.K

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbime dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 9,999.00 €.

Me 24.07.2023 OE “AsTech” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me datën 28.07.2023, AK- Qendra Kryesore e Mjekesise Familjare ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 24.07.2023 AK - Qendra Kryesore e Mjekesise Familjare ka publikuar B08 –Njoftimin per dhënie të kontratës ndërsa me datën 25.07.2023 ka publikuar B11- njoftimin për anulimin e dhënies së kontratës.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues “AsTech” SH.P.K. me datën 07.08.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 553/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore. Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nën-paragrafin 75 të LPP.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “AsTech” SH.P.K., janë parashtruar përmes ankesës si në vijim: “Ankesa jone lidhet me Vendimin e AK-se te dates 17.07.2023 ku AK shperblen OE Termovision si te përgjegjshëm. Ne procesverbal te hapjes kemi qene pjesëmarrës tre OE, AK shpërblen OE me te lire me çmim po qe nga qasja ne dokumentacion qe kemi pasur kemi analizuar dhe vertetuar se OE ne fjale nuk eshte i pergjegjshem. OE nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate: III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:" Ofertuesit duhet të ofrojn dëshmi se ka kontrata apo kontratë të realizuara të natyrës së njejtë për periudhën e shkuar tre vjeçare, e cila ndërlidhet me periudhën qe paraprinë datën e publikimit te Njoftimit për Kontratë. Vlera e përgjithshme monetare për shërbime të njejta jo më e vogel se 14,900.00" Dëshmia e kërkuar dokumentare: Lista e kontratave të realizuara së bashku me referenca përkatëse, raporte (dëshmi vetëm te natyres perkatse Aneksi 1 DT). Kerkesa e AK-se ka qene per referenca te NATYRES SE NJEJTE, prandaj meqenëse OE ka sjell kontrata te perziera si te vlefshme duhet ti merren veten pozicionet ku ka Furnizim me klima ose skërmisim te tyre. Nga sqarimet qe AK i ka kerkuar permes letres standarde dhe pergjigjet qe AK ka sjell kuptojme se OE nuk e permbush ketë kërkesë. Kontrata dhe deshmite nga "Dekor" - Podujeve, jane leshuar para se te përfundojnë Kontrata e "Dekor" me Komunen e Suharekes. Sipas listes se kontratave data e fillimit eshte 10.05.2020 ndërsa data e përfundimit eshte 11.10.2021. OE ne oferte ka dorëzuar nje Reference te dates 07.06.2021, qe daton para përfundimit të tërësishëm te projektit sipas listes se kontratave. Poashtu ngjit me reference eshte edhe nje Situacion me nje date krjet tjeter 15.11.2021. Kontrata eshte lidhur me Komunes se Suharekes dhe Dekor dhe askund nuk kemi dëshmi se investitor eshte vete Termovision, madje as dëshmi bankare nuk kemi, si mund te pranohet nje reference pa deshmi bindëse por vetëm te dhëna dyshuese qe ngjallin dyshime tjera. Por edhe nëse OE sjell dëshmi qarkullimi bankar vlera e te gjitha klimave qe OE thote se ka furnizuar ose servisuar nese flasim per kontrata-pozicione te natyrës se njejte

ashtu siq AK e ca cek ne dosje atehere nuk e arrin vlerën e kerkuar. Kontrata me Strabag ka te bashkangjitur edhe përshkrimin e puneve qe jane kryer per kete kompani, kontrata ka pozicione te natyrave te ndryshme por qe nuk e arrijne vleren e kerkuar nga AK. DMTH OE nuk e plotëson ketë kërkesë. OE ne oferte ose ne sqarime ka ngarkuar edhe nje raport te punimeve per tenderin Renovimi dhe mirmbajtja e ngrohjes qendrore me Komunen e Podujeves, tek i cili jane disa pozicione per servisim te klimave por qe eshte shume i ngatërruar sepse jane ngarkuar dy raporte ndersa tek secili eshte cekur Vendi i objektit ose shkollës ku eshte bere servisimi dhe qe shpesh jane objekte te perseritura. Perveq qe eshte i paqarte eshte edhe dyshues dhe i papranueshëm sepse ne te dy raportet jane vlera te ndryshme te shkollave te njejta, dhe te dyja nuk mund te jene te vlefshme por vetem njera. Perfundimisht deklarojem se kontrata me privat mund te jene te pranueshme nese jane te deshmuara me qarkullim banakr dhe nuk akne devijime mes datave qe ngjallin dyshime, poashtu kontrata te pranueshme jane vetem nese jane te natyres se njejte me kete aktivitet. Ne pergjigjen e kerkeses per rishqyrtim AK eshte mundur te arsyetoj Vendimin e saj duke pershkruar pozicionet qe i ka llogarite per referenca te njejta por ky arsyetim nuk qendroj sepse Kerkese e AK-se ka qene referenca te natyres se njejte dhe jo te ngjashme. Per natyren e tenderin per Klima montuese te thjeshta dhe servisimin e tyre AK nuk mund ti pranoj si refrenca te natyrës se njejte ato te përfunduara per Fankoilla, Nxemje qendrroe ose qillera, jane natyre krjet tjeter per ata qe e njofin kete fushe. Kerkojme vleresim te drejte te tenderit, kthimin e lendes ne rivlerësim dhe udhëzimin e AK per respektim te kritereve qe vete i ka vendosur ne dosje te tenderit, rrjedhimisht shpërblimin e ofertes tone me kontrate."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE "AsTech" SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7, 59 dhe 60 të LPP.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues ka autorizuar dy ekspertë si në vijim :

Me datë 11/08/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 553/23, ndërsa me datë 22/08/2023 është dorëzuar raporti i eksperteve me nr. 2023/0553 me rekomandimet si në vijim: "*eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar, të mbetet në fuqi vendimi i AK."*

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues duke theksuar "*nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit, meqense kerkesa e dosjes ka qene referanca te natyres se njete konsiderojme se OE nuk ka kryer kontrata të kesaj natyre."*

Me datë 09/10/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për përgatitjen e super ekspertizës sipas ankesës me nr. 553/23, e cila është dorëzuar 31.10.2023 me rekomandimet si në vijim: *eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar, kurse po ashtu ka rekomanduar që të mbetet në fuqi vendimi i AK."*

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertizës dhe super ekspertizës, mendimet e palëve lidhur me raportet e eksperteve,

parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit, deklarimet e palëve gjate seancës së shqyrtimit kryesor si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Me datën 03.10.2023 është mbajtur seanca e shqyrtimit kryesor lidhur me ketë lëndë ku prezent ishte përfaqësuesi i Autoriteti Kontraktues ndërsa ka munguar përfaqësuesi i palës ankuese.

Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktuesgjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se të gjthë OE i kanë trajtuar në mënyrë të barabartë, në respektim të neneve specifikisht – Nenin 7, Nenin 59 si dhe Nenin 60. Bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, harmonizuar me Rregulloren dhe Udhëzuesin në fuqi. Ripotencoj se vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë në përputhëshmeri me kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë dhe po ashtu nxjerrja e vendimit është bër në përputhje me dispozitat e LPP-së dhe legjislacionit në fuqi, prandaj pretendimet e pales ankimore nuk kanë bazë ligjore. Vetëm ga te tri kontratat e prezantuara në ofertqn e OE të rekomanduar si: si Komuna e Podujevës, Strasbag , Shtepija e te moshuarave cituar në vlera 5451.25 +9620+3470 ne total përbëjnë 18541.25€ që është specifikisht 100% janë vetëm kondicioner mirëmbajtje dhe furnizim me kondicioner, andaj ne konsiderojmë se OE i rekomanduar e ka plotësuar këtë kërkesë dhe kërkojmë që vendimi i AK të vërtetohet.

Eksperti shqyrtues në raportin e datës 22.08.2023 ka konstatuar shkurtimisht si vijon:

OE"AS Tech" SH.P.K i pakënaqur me vendimin e AK- se, konform nenit 108/A ka parashtruar ankesë me pretendimin se AK nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 59 te LPP-se, me këtë rast ka rekomanduar për kontrate një operator ekonomik i cili nuk i plotëson kriteret e dosjes se tenderit. OE ankues me datën 17.07.2023, ka pranuar vendimin e AK-se dhe letrën standarde si tenderues i pasuksesshëm, ndërsa ne ankesën e tij ka pretendim se OE i rekomanduar për kontrate, nuk ka ofruar kontrata te natyrës se njëjtë, sipas kërkesës se dosjes se tenderit, ku AK-ja ka kërkuar: Ofertuesit duhet të ofrojn dëshmi se ka kontrata apo kontratë të realizuara të natyres së njejtë për periudhën e shkuar tre vjeçare, e cila ndërlidhet me periudhën qe paraprirë datën e publikimit te Njoftimit për Kontratë.Vlera e përgjithëshme monetare për shërbime të njejta jo më e vogel se 14,900.00. Eksperti shqyrtues, sqaron se ne ankesën e tij OE ankues i konteston kontratat veq e veq për te cilat pretendon se OE i rekomanduar për kontrate, nuk e arrin vlerën e kërkuar sipas dosjes se tenderit. Eksperti shqyrtues pasi ka analizuar listën e kontratave vlerëson se nuk qëndron ky pretendim i OE ankues, sepse me vetëm kontratën **me nr. rendor 7**, i rekomanduari për kontrate e plotëson kërkesën e dosjes se tenderit.

Po ashtu lidhur me ketë pretendim eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk qëndron pretendimi i OE ankues se kontratat e dorëzuara janë me operatore ekonomik privat dhe te njëjtat nuk duhen te merren parasysh, me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontrate nuk i ka bashkangjitur qarkullimin bankar.

Me qëllim të vërtetimit të saktë të gjendjes faktike, pasi që në raportin paraprak të ekspertit shqyrtues të datës 22.08.2023 dhe përgjigjeve të AK lidhur me plotësimin e kërkesës në DT për punë të kryera me natyrë të njëjtë meqenëse ishin të ndryshme, për faktin se eksperti shqyrtues e kishte pranuar në tërsi kontratë nr. rendor 7 dhe vetëm mbi bazën e saj kishte konstatuar se OE i rekomanduar e kishe plotësuar këtë kriter kurse AK prej kontratës të njëjtës kontratë me numër

rendor 7 kishe pranuar vetëm pjesërisht dhe atë vetëm 5,451.25e kurse nga ana tjetër Ankuesi përmes parashtresave e kundërshton në tërësi këtë kërkesë me prtendimin se ankuesi nuk e kishte plotësuar, paneli shqyrtues pas shqyrtimit kryesor caktoj një super ekspertizë për të pasqyruar kontrata e natyrës së njejtë të përfunduara nga OE i rekomanduari. Lidhur me këtë me 31.10.2023, Eksperti shqyrtues sipas raportit të super-ekspertizës ka sqaruar se ankuesi i ka kontestuar kontratat të gjitha me bindjen se nuk e arrin vlerën e kërkuar sipas dosjes se tenderit. Eksperti shqyrtues pas analizimit të kërkesave të dosjes fillimisht konstaton se kërkesa e dosjes ka qenë shumë decidive ku përveq kërkesës për "natyrë të njëjtë" të kontratave, në fund të kërkesës ka kërkuar shprehimisht "Vlera e përgjithëshme monetare për "Vlera e përgjishtshme **shërbime të njejta jo më e vogel se 14,900.00.** Me qenë se qëllimi i këtij aktiviteti të prokurimit sipas vet dosjes së tenderit është për "Mirëmbajtje,furnizim me klimave për QKMF-në dhe të gjitha njësit e saj si dhe mirëmbajtja e sistemit të klimatizimit dhe ventilimit në QMF-Besi." Atëherë mendimi i ekspertit është se shërbime të njëjta duhet konsideruar vetëm furnizimi dhe servisimi i klimave DHE ventilimi. kurse pas analizimit të ankesës, dosjes së tenderit, si dhe dëshmive të ofruara nga AK konkretisht paramasat e kontratave të ofruara nga OE i rekomanduar, kemi gjetur se OE Termovizion përmes kontratave me DEKOR dhe me STARBAG, arrin shumën mbi 15,071.00€ në shërbime të njëjta, do thotë shërbime për furnizim dhe servisim të klimave dhe ventilim. Provë: Paramasat e kontratave të OE të rekomanduar për kontratë Provë: Procesverbali i seancës për shqyrtim kryesor i datës 03.10.2023 Nga kjo llogaritje kemi përjashtuar qfardo shërbimi nga kontrata me KK Podujevë e cila ende nuk është e përfunduar. Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar. kurse rekomandojmë ,mbetjen në fuqi të vendimit të AK"

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat për të pretendohet nga operatori ekonomik ankues. Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues pa nevoj që të njëjtat të përshkruhen sërish në detaje. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat për të pretendohet nga operatori ekonomik ankues. Në rastin konkret nga raporti i eksperteve shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar vendimin e Autoritetit Kontraktues i dates 17.07.2023lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe mirëmbajtje te klimave ne QKMF dhe njësit e saj" me nr. të prokurimit: 73350-23-6551-2-3-6, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Qendra Kryesore e Mjekesise Familjare, ngase mbi bazën e raportit të super-ekspertizës u konstatua saktë se Oe i rekomanduar e ka plotësuar kërkesën për punë të natyrës së njejtë me anë të kontratave të prezantuara në ofertë dhe atë në vlerë 15,071.00€ nga 14,900.00€ sa ishte kërkuar.

Pa nevojë për analiza tjera të pretendimeve ankimore dhe provave tjera, OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore mirëpo AK duhet të kujdeset ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së. Prandaj bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e eksperteve shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit i përshkruar si me sipër të kthehet sërish në ri-vlerësim. Rrjedhimisht kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, Paneli sqaron po ashtu se në vështrim të kërkesave të autoritetit kontraktues të cilat precizohen në dosjen e tenderit dhe si të tilla bëhen publike për të gjith ofertuesit eventual, natyrisht se secili duhet të udhëhiqet nga parimi i kujdesit në përmbushjen e kushteve formale në kohë dhe brenda afatit. Andaj Paneli Shqyrtues vlerëson se AK ka vepruar në përputhje të plotë me nenin 59 paragrafi 4 të LPP-së "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"*

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **QENDRA KRYESORE E MJEKSISE FAMILJARE**
- OE - **" AS Tech " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: